

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Këshilli i Ministrave

VENDIM
Nr. 1596, datë 26.11. 2008

PËR KRYERJE PAGESASH, NË FORMË KONTRIBUTI, NË FONDIN E
PËRBASHKËT TË NATO-S

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 44, të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të pikës 11, të nenit 14, të ligjit nr.8671, datë 26.10.2000, "Për pushtetet dhe autoritetet e komandimit e të drejtimit strategjik të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 8, të ligjit nr.9836, datë 26.11.2007, "Për buxhetin e shtetit, të vitit 2008", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministria e Mbrojtjes të kryejë pagesën, në vlerën 30 000 000 (tridhjetë milionë) lekë, në formë kontributi, në fondin e përbashkët të NA TO-s, për të mbështetur ngritjen e forcës së sigurisë në Kosovë.

Pagesa të kryhet në llogarinë:

REF: KFS Trust Fund

Bank FORTIS Bank

Account name: S HAPE

Adress Montagne du parc 3 B-1000 Brussels, Belgium

IBAN account: BE25 210000100082

SWIFT/BIC GEBABEBB

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i vitit 2008, miratuar për Ministrinë e Mbrojtjes.

3. Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në "Fletoren zyrtare".

KRYEMINISTRI
SALI BERISHA

MINISTRI I MBROJTJES
GAZMEND OKETA